

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndricimi i Njesive Administrative dhe Bashkise Peqin.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
45231400-9 Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 10.000.000 ( dhjete million) leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Ofertuesi duhet të paraqese:**

## **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"si dhe nenit

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (*tre*) viteve të fundit (**2021,2022,2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe tekontabilistit te miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt- ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure (Procedure e hapur e thjeshtuar) në mbështetje të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

**2.2.2** Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (*tre*) viteve të fundit (**2021,2022,2023**), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlerat e xhiros për të paktën një nga vite e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurrohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: **i**) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; **ii**) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; **iii**) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga organet e pushtetit lokal ( Bashkia) per shlyerjen e **taksave vendore te maturuara per vitin 2024** (per NIPT-in kryesor dhe per NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.”

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

- a. **2.3.1.** punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**ose**

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashkë gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se i vlera totale kontratës që prokurohet(*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

*a.Kontraten/at e*

*Sipërmarrjes, b.Situacion*

*përfundimtare të objektit,*

*c.Faturat tatimore për çdo situacion,*

*d.Formular Vleresimi nga Investitori*

*e.Akti i Kolaudimit,*

*f. Certifikata e marrjes ne dorezim*

*g.Kontrata e bashkepunimit ndermjet O.E ku te jete e perfshire marreveshja e ndarjes sepunimeve mes paleve.*

**Shenim;** *Per piken g) te paraqitet per kontrata te ngjashme te realizuara si bashkim operatoresh. Kjo kerkese vjen si arsye per AK per te patur nje vleresim sa me te drejte per punimet dhe zerat e realizuar ne kontrata te ngjashme. Detyrimisht nga OE pjesemarrres ne kete procedure duhet te paraqitet kontrata e bashkepunimit. Ne rast te mos paraqitjes do te jete kusht mos pranimi si pune e ngjashme.*

- *Nese kontrata eshte realizuar jo nga te gjithë anetaret e bashkimit te perkohshem atehere,detyrimisht te paraqiten dokumenta si me poshte :*
  - *Material provues te falimentimit te përfaqesuesit te bashkimit të operatorëve ekonomike;*
  - *Materiale te rethanave të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës;*
  - *Miratimin e Autoritetit Kontraktor per vijimin e metejsheem si dhe perfundimin e punimeve ngaanetari/anetaret e tjere.*

*Mos paraqitja e dokumentave te mesiperme do te jete kusht mos pranimi si pune e ngjashme pasi dote konsiderohet se bashkimi i perkohshem i operatoreve gjendet ne kushtet e mospermbushjes se detyrimeve te kontrates nga ana e kontraktorit.*

- *Per kontrata te ngjashme te realizuara ne rolin e nenkontraktorit, detyrimisht te paraqitet :*
  - *Deklarimi i O.E./B.O.E. fitues ne procedure perkatese per caktim te nenkontraktorit;*
  - *Konfirmimi i nenkontraktorit nga AK, me zerat perkates te punimeve/sherbimeve/mallrave qe kamarre persiper per te realizuar;*
  - *Formularin e vleresimit per realizimin e punimeve ka realizuar me sukses si dhe;*
  - *Faturat tatimore te shoqeruara me Situacionet e nenshkruara nga mbikqyresi i punimeve.*

- Për kontrata për punë është realizuar me subjekte private te paraqiten:

- a) Kontraten/at e Sipërmarrjes;
- b) Situacion përfundimtare të objektit;

- c) Faturat tatimore për çdo situacion;
- d) Akti i Kolaudimit;

*pikë 2.3.1 gërma "a" plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

*Kurse pika 2.3.1 gërma "b" duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik").*

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure (Procedure e hapur e thjeshtuar) në mbështetje të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

---

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin emiratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Punime të Përgjithshme Ndërtimi**

- NP.11-A, Ndertime për n/stacionet, kabinat e transformatoreve, linja e TN e të mesem dhe shpërndarjen e energjisë.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukurës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues

**Argumentimi:**



Operatorët ekonomik duhet të caktojë me anë të një dekaratë Drejtuesin Teknik të punimeve i cili duhet të jetë i përfshirë në license e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhedo të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Ne lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas një standarti të pershtatshëm cilesie. Per sa me siper, eshte e nevojshme qe Operatoret ekonomike te pasqyrojne referenca te pershtatshme nga kontratat te zbatuara ne te shkuaren nga ana e tyre.

- **Inxhinieri Elektrik:** eshte pergjegjes per zbatimin e projektit te miratuar, sipas kushteve teknike per punime ne linja dhe kabina elektrike percaktuar sipas Rregullores se Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik.

**2.3.4** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafinmbështetës** si më poshtë:

- a. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier".
- b. Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj

emergjencave”, e cila të jete e leshuar nga shoqeri të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:*

- a) Kontrate pune;**
- b) diplome/certificate**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

**Argumentimi:** Ne baze të VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në dispozitën III-pika 10.5 / 10.12 / 10.13 / dispozita IV-pika 7-a,b,b1,b2,b3,c1-shprehet qartësisht aftësitë që duhet të ketë punonjësi i ngarkuar për menaxhimin e riskut I cili duhet të plotësojë kushtet në lidhje me çështjet e sigurisë në punë.

Gjithashtu në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë” dhe VKM Nr.312 Dt: 5.5.2010 për “Miratimin e rregullores” Për sigurinë në Kantier”.

Vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që operatori ekonomik ,në këtë mënyrë lidhur me masat tekniko-organizative që do të ndërmarre, do të shmangë edhe rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë zbatimit të punimeve dhe do të realizojë ato sipas standarteve ligjore në fuqi.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar, punonjës të kualifikuar, të pajisur me dëshmi profesionale sipas profesioneve si më poshtë:

- 5 (pese) Elektracist

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :*

Kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi profesionale përkatëse dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) aponga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit .

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës



të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

**Argumentimi :** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të pakten **10 punonjës** të specializuar/kualifikuar, të cilët duhet të jenë me statusin **elektracist**, të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë, të pajisur me kontratë pune, deshmi profesionale (diplome, certifikata trajnimi etj) si dhe deshmi kualifikimi të Sigurimit Teknik.

*Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.*

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)*

**Argumentimi :** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar te pakten **1 (një) manovratorë** të mjeteve të rënda nga “automakini”, të paraqitet kontratë pune, deshmi e drejtimit nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme.

*Ne rastet kur makinerite disponohen me qira, nuk është e nevojshme që manovratori i mjeteve të figurojë në listepagesat e shoqërisë. Ne këtë rast ata duhet të kenë të vlefshme vetëm kontratën e punës dhe deshmitë e drejtimit.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar,

neni 26“*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, pika 6 “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese*”, **si më sipër kërkuar.**

#### **Argumentimi :**

Lidhur me kriterin e kërkuar si me sipër, komisioni është bazuar referuar Ligjit Nr.162 date:23.12.2020”Per prokurimin publik”neni 77,dhe neni 44,pika 1 te VKM nr.285,date 19.05.2021”Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ku nisur nga percaktimi I kerkesave per kualifikim per Operatorin Ekonomik bazuar ne aftesite teknike dhe profesionale citon se: “*Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*”

Komisioni vendosi të kërkojë certifikatat e mësipërme për të vërtetuar që Operatori Ekonomik disponon licensat mbi menaxhimin e cilesise se punimeve,i lidhur ngushte me objektin e prokurimit duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

**2.3.8** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore **minimalisht 25( njezet e pese) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për një periudhë 3 muajore nga data e zhvillimit të tenderit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj
- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislati në fuqi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, neni 26 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, pika 6 “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese*”, **si më sipër kërkuar**

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën

objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe menaxhimit të energjisë. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- a) ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e vlefshme, ose ekuivalente
- b) OHSAS 18001 : 2007 mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë” e vlefshme, ose ISO 45001:2018 ose ekuivalente

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe gjatë periudhës sëparashikuar për zbatimin e kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

**2.3.10** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Autovinç/Kamion me vinç,kapaciteti mbajtes minimum 5 (pese) ton.	1 cope	Pronësi ose me qera
Automjet me kosh	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës deri 3.5)	1 copë	Pronësi ose me qera

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:

- certifikatën e pronësisë;
- lejen e qarkullimit;

- certifikaten e kontrollit teknik;
- siguracionin;
- certifikate transporti lëshuar nga njësiti e qeverisjes vendore dhe fotot perkatese;

ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithëperiudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata eblerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatese fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, nuk janë të angazhuara në procedurat e shpallura fitues nga autoriteti kontraktor dhedo të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtuedhe gjatë zbatimit të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtoresh, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## **NJESIA E PROKURIMIT**